



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 65

Prishtinë, më 24 dhjetor 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 303

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Behar Selimi, Haki Demolli, Ardian Gjini, Mufera Şinik, Halit Krasniqi, Gëzim Kelmendi, Arsim Bajrami, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj dhe Jasmina Zhivković.

Mungoi: Arben Gashi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Lumniye Murati – ZPRK, Vlora Marmullakaj – EULEX, Artan Canhasi – EULEX, Arton Demhasaj – Çohu, B. Sadiku dhe Blerim Kelmendi AKK, Visar Smajlaj – ekspert dhe Shkëlzen Gërxhaliu – praktikant.

Nga Stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Behar Selimi, nënkryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 26.11.2012;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Agjencinë Kosovare për krahasim dhe verifikim të pronës;
4. Shqyrtimi i strategjisë dhe plani i veprimit kundër korrupsionit për vitin 2013-2017;
5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin Nr. 04/L-159 për zonat ekonomike;
6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin Nr. 04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional;
7. Shqyrtimi i kërkesës së Gjykatës Kushtetuese KO 97/12;
8. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 26.11.2012

Kryesuesi konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 26.11.2012, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Agjencinë Kosovare për krahasim dhe verifikim të pronës

Albulena Haxhiu – Për këtë projektligj është diskutuar edhe në mbledhjen e kaluar dhe ne u pajtuam që ai të kthehet prapa. Projektligji i jep kontroll të plotë përfaqësuesit special të BE-së, pasi shumica e anëtarëve të bordit dhe sekretarisë do të emërohet drejtpërdrejt nga PSBE-ja. Prandaj shtroi pyetjen se nga e merr mandatin PSBE-ja që të emërojë funksionar ekzekutiv gjyqësor, në kohën kur tashmë ka përfunduar mbikëqyrja e pavarësisë. Gjithashtu cilësoi se edhe ligji, por edhe institucioni që ky ligj e themelon janë të panevojshme pasi ky ligj e formalizon faktin që librat e kadastrave të Kosovës t'i mbajë Serbia. Si propozim deputetja Haxhiu tha se ky ligj duhet të kthehet prapa.

Ardian Gjini – Tha se Komisioni duhet të votojë me rekomandim që seanca ta miratojë ose të mos e miratojë projektligjin, por, ne, si Komision, nuk mund t'ia kthejmë atë qeverisë.

Armend Zemaj – Tha se ne tashmë kemi një rast i cili prek këtë fushë, rasti ka të bëjë me kishën ortodokse në Deçan, të cilës në mënyrë të padrejtë i janë dhënë prona nga pushteti i atëhershëm serb, dhe që në vitin 2004 janë legalizuar ato padrejtësi. Prandaj ai rekomandoi që ligji të analizohet dhe t'i nënshtrohet ekspertizës së nevojshme se çka synon të arrijë ligji dhe se si do të implementohet ai në praktikë. Gjithashtu tha se duhet definuar edhe roli dhe përgjegjësit ekzekutive të përfaqësuesit special të BE-së.

Albulena Haxhiu – Theksoi se ligji është kriminal, pasi në një anë Serbia ka vjedhur librat kadastrale nga Kosova, dhe në anën tjetër forma e dhunshme me të cilën Serbia e ka trajtuar pronën në Kosovë, ka qenë kriminale. Prandaj ajo kërkoi që fillimisht ta kemi një ligj, i cili verifikon kopjet e regjistrave kadastrale të sjellë nga Serbia. Ajo tha se Komisioni duhet t'i rekomandojë seancës që ligji t'i kthehet qeverisë.

Arsim Bajrami – Tha se Komisioni ka mundësi që të dërgojë rekomandim në seancën plenare për miratim ose mos miratim të projektligjit. Mirëpo më rationale do të ishte që të mos ngutemi dhe këtë çështje ta shtyjmë për vitin 2013, me kusht që prezent të jetë edhe përfaqësuesi i qeverisë, i cili do ta arsyetojë qëllimin e këtij ligji, pasi ky nuk është një ligj i rregullt, por ka të bëjë me krijimin e një agjencie specifike, ku në vend të reduktimit të tyre ato vetëm sa po shtohen, duke ngarkuar kështu edhe administratën.

Komisioni me 9 vota për dhe 1 votë kundër vendosi që ta shtyjë këtë pikë të rendit të ditës për një mbledhje të radhës.

4. Shqyrtimi i strategjisë dhe plani i veprimit kundër korrupsionit për vitin 2013-2017

Albulena Haxhiu – Duke folur për strategjinë ajo vlerësoi se korrupsioni nuk luftohet me plane të këtilla, të mbushura me fraza klishe siç janë: strategjia, plani, bashkëpunimi, reforma, pra terme të cilat i kemi dëgjuar shumë herë, por që nuk ka asgjë konkrete. Agjencia Kundër Korrupsionit duhet të insistojë te qeveria që të kompletojë pakon anti-korrupsion, ku bëjnë pjesë Ligji për Konfiskimin e Pasurisë së Fituar në Mënyrë të Kundërligjshme, si dhe Ligji Anti-mafia. Kjo strategji në asnjë faqe të vetme nuk e cek në mënyrë konkrete se si do ta luftojë korrupsionin, kurse Agjencia Kundër

Korrupsionit nuk ka marrë për bazë raportet të cilat tregojnë natyrën, shkaqet dhe nivelin e korrupsionit në Kosovë. Po ashtu nuk është bërë ndonjë analizë e thuktë mbi zbatueshmërinë e strategjisë kundër korrupsionit 2009-2011, duke pamundësuar kështu të evidentohen të metat e asaj strategjie, të cilat do duhej të përmirësoheshin pastaj në këtë strategji.

Ardian Gjini – Tha se është dashur që përfaqësuesit e agjencisë të jenë të pranishëm dhe ta mbrojnë strategjinë, sepse ne e dëgjuam përfaqësuesin e shoqërisë civile, i cili i ka evidentuar mangësitë, dhe ne, si anëtarë të Komisionit, jemi përfaqësues politikë, që vendimet i marrim në bazë të bindjes që e fitojmë nga prezantimi i argumenteve të tyre. Si çështje të dytë ai e ngriti faktin që duhet të jetë e qartë se Agjencia Kundër Korrupsionit nuk është mjet i drejtpërdrejtë i punës për luftimin e korrupsionit. Ngase është themeluar vetëm si agjenci për t'i ndihmuar politikës për ta luftuar këtë dukuri. Pra, agjencia është thjesht një institucion i cili propozon politika dhe ligje, që nënkupton se pa vullnet politik ne mund të hartojmë edhe dhjeta strategji të tilla, por që nuk do të ketë kurrfarë rezultati. Megjithatë ai dhe partia e tij do të votojnë pro kësaj strategjie, pasi për momentin nuk ka rrugëdalje tjetër, me shpresën që së shpejti ky dokument do të rishkruhet tërësisht.

Haki Demolli – Ishte skeptik në këtë strategji për faktin se tashmë kemi pasur 2 dokumente të tilla të cilat nuk kanë dhënë ndonjë rezultat, dhe vetë pozita e ultë e Kosovës në vlerësimet e raporteve ndërkombëtare për korrupsionin, janë dëshmi se strategjitë paraprake nuk kanë treguar kurrfarë suksesi. Gjithashtu ai përmendi edhe koston buxhetore, dhe ngriti dyshime nëse duhet të shpenzohen shuma të tilla kur kemi parasysh mungesën e rezultateve nga strategjitë e më hershme.

Armend Zemaj – Tha se mendimi i subjektit të tij politik për strategjinë në fjalë u përmend nga deputeti Demolli, kurse kritikoi mungesën e prezencës së kryetarit të Agjencisë, të cilën e cilësoi si mungesë përgjegjësie, për faktin se po flitet për një strategji afatgjatë. Ndonëse kjo agjenci duhet ta luajë rolin e tij, ashtu siç definohet me ligj, vërehet se nuk është përcaktuar qartë se cili është roli i Agjencisë Kundër Korrupsionit, cila është gjendja ekzistuese dhe cilat do të jenë masat që do të ndërmerren.

Halit Krasniqi – Tha se nuk është mirë që Agjencia ta injorojë Komisionin dhe është dashur të jetë i pranishëm këtu drejtori i Agjencisë. Tha se mund të ketë vend për plotësime në këtë strategji, mirëpo do ta votojë këtë strategji për seancë.

Gëzim Kelmendi – Tha se korrupsioni në Kosovë është i përhapur jo vetëm në institucione, por edhe në popull. Prandaj kërkoi që institucionet të jenë më objektive dhe më praktike. Po ashtu shtoi se gjendjen e bën edhe më të rëndë fakti se institucionet të cilat do duhej ta luftonin këtë dukuri janë edhe vetë të korruptuara, duke përmendur këtu gjyqësorin, sistemin prokurorial, etj. Prandaj do duhej të luftohej kjo hallkë në mënyrë që të arrihen te institucionet.

Kryesuesi – Tha se dokumenti është i krahasueshëm me strategjitë e vendeve që kanë një dokument të tillë. Dokumenti ka qëllime të përgjithshme dhe ai nuk mund të jetë një plan operacional. Ai vetëm i përcakton qëllimet për institucionet e tjera.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni me 6 vota për, 1 abstenim dhe 3 vota kundër vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë

R e k o m a n d i m

Të shqyrtohet dhe të miratohet strategjia dhe Plani i Veprimit kundër korrupsionit për vitin 2013-2017

5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin Nr. 04/L-159 për zonat ekonomike

Kryesuesi - Paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit Funksional në Projektligjin për zonat ekonomike dhe kërkoi nga anëtarët që të deklarohen, nëse kanë vërejtje.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Legjislacion, me 7 vota për dhe 3 kundër nxori këtë:

Përfundim

1. Projektligji Nr. 04/L-159 për zonat ekonomike dhe amendamentet e propozuara, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin Nr. 04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional

Kryesuesi - Paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit Funksional në Projektligjin për Arsimin dhe Aftësimin Profesional dhe kërkoi nga anëtarët që të deklarohen, nëse kanë vërejtje.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion, njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji Nr. 04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional dhe amendamentet e propozuara, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

7. Shqyrtimi i kërkesës së Gjykatës Kushtetuese KO 97/12

Komisioni vendosi që kryetari i Komisionit dhe nënkryetarët ta vlerësojnë se a është e nevojshme t'i paraqesin komentet lidhur me kërkesën e Gjykatës Kushtetuese për ligjin Nr. 04/L-093 për bankat institucionet mikro- financiare dhe institucionet financiare jo bankare.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20.

E përgatiti:
Stafi Mbështetës i Komisionit.

Nënkryetar i Komisionit

Behar Selimi